# Kape të sotmen, e nesërmja nuk është e jotja



Në këtë kohë kjo mund të jetë e vështirë për shumicën prej nesh, mirëpo Allahu na ka ofruar shumë mënyra tjera për ta fituar lehtësimin në Ahiret. Këtu përfshihet leximi i sures Ul-Mulk, për shkak se Muhammedi s.a.v.s. ka thënë: "Sureja Tabarak është mbrojtës nga torturat e varrit" (Transmeton Hakimi). Muhammedi s.a.v.s. poashtu ka thënë: "Kur vdes një njeri, të gjitha veprat i ndalen përveç sadakasë rrjedhëse, diturisë Islame nga e cila përfitojnë të tjerët dhe fëmijës së drejtë (udhëzuar) i cili lutet për të" (Transmeton Muslimi)

Një mënyrë tjetër për të përfituar shpërblim të vazhdueshëm është ringjallja e ndonjë Sunetit të humbur të Muhammedit s.a.v.s. Ai, s.a.v.s. ka thënë: "Ai që fillon (inicon) një mënyrë të mirë në Islam shpërblehet për të, duke përfshirë edhe shpërblimet për ata që e pasojnë atë, pa zvogëluar asnjë nga shpërblimet e tyre" (Transmeton Muslimi)

Për ata që njoftin muslimanë që kanë filluar udhëtimin e tyre, ose që janë gati ta fillojnë atë, për në botën tjetër, ekzistojnë gjëra që ndihmojnë në kalim (tranzicion) sa më të lehtë, inshaAllah. Këtu përfshihet falja e namazit të xhenazes, plotësimi i premtimeve të të vdekurit, larjes së borxheve të të vdekurit dhe faljes\lutjes për muslimanët.
Jeta po ik. Vdekja po afrohet. Le të bëhemi gati…

***Sumayyah bint Joan***
***Përgatiti: Klubi Studentor - Shkup***

---

Klubi Studentor

**Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.**



Pasi mora vesh për vdekjen e një miku musliman, fillova të mendoj se sa e shkurtë dhe e shpejtë është jeta, dhe se unë jam larg tij vetëm sa të mbyll dhe të hap sytë.

Vdekja është një realitet nga i cili askush nuk mund të ikë. Ajo afrohet çdo ditë e më afër, çdo orë, çdo minutë. E pyeta veten, nëse do të vdisja sot, a jam unë ai që i kam bërë të gjitha veprat për të siguruar Pëlqimin e Allahut, dhe për t'iu shmangur Zemërimit të Tij? Për fat të keq, për mua përgjigjja ishte JOOO.

Sërish e pyes veten, çfarë vepre të mirë kam bërë që do të jetë e dobishme për shpirtin tim? Dhe sërish, përgjigjja është negative - shumë pak.

Koha, siç e shofim, po kalon shumë shpejt. Më duket sikur dje fillumë "Vitin e ri", ndërsa në realitet kemi kaluar një pjesë të mirë të tij. Një muaj duket sa një javë, një javë duket sa një orë, dhe një orë duket sa disa minuta.

Për këtë shkak vendosa të bëj çmos, me ndihmën e Allahut, të shfrytëzoj çdo rast për të bërë vepra të mira, e mos t'i lë për më vonë gjërat që mund t'i bëj tani.

Vdekja po vjen, a je gati?

Allahu thotë: **"Secili njeri do të shijojë vdekjen, e shpërblimet tuaja u plotësohen ditën e kijametit, e kush shmanget zjarrit e futet në xhenet, ai ka arritur shpëtim, e jeta e kësaj bote nuk është tjetër pos një përjetim mashtrues. (Ali Imran: 185)**

Shumë lehtë ngatërrohemi në zhvillimet e përditshme të jetës, tentojmë të harrojmë se nuk jemi përgjithmonë në këtë botë, dhe të largohemi nga qëllimi i vërtetë. Sikur harrojmë se në këtë botë kemi ardhur për ta adhuruar Allahun dhe për të përfituar nga rastet e ndryshme. Ai na lejon që ne të grumbullojmë pasurinë tonë në Xhennet. Për shkak se Ai, subhanehu ve te'ala, poashtu thotë:

**"O ju që besuat, kinie parasysh frikën ndaj All-llahut dhe le të shikojë njeriu se çka ka bërë për nesër, dhe kinie frikë All-llahun, e s'ka dyshim se All-llahu është që e di në detaje atë që punoni! E mos u bëni si ata që e harruan All-llahun, e All-llahu bëri që ata ta harrojnë vetveten! Të tillët janë ata të prishurit. Nuk janë të barabartë ata të Xhennetit dhe ata të Xhehennemit. Banuesit e Xhennetit janë ata fatbardhë që ia kanë arritur qëllimit". (Hashr: 18-20)**

Ai poashtu na tregon se ne nuk e dimë momentin ose vendin e vdekjes. Mirëpo, Ai, nëpërmjet Mëshirës së pafund ndaj nesh, na ka dhënë mënyra për t'u përgatitur për të pashmangshmen tani, për shkak se kur ta kalojmë këtë botë e të dalim në tjetrën, nuk ka kthim prapa për t'i bërë punët që është dashur t'i bëjmë. Allahu thotë:

**"E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: "O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e të kompensoj atë që lëshova!" Kurrsesi, (Kthim nuk ka) e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde (distancë periodike) der në ditën kur ringjallen". (Mu'minun: 99-100)**

Allahu na ka dhënë mënyra për ta mbrojtur veten nga dënimi i varrit. Një nga këto mënyra është lufta në rrugë të Allahut. Transmetohet se një njeri ka pyetur Muhammedin s.a.v.s.: "O i Dërguari i Allahut pse të gjithë besimtarët sprovohen në varr përveç shehidëve (dëshmorëve)? Muhammedi s.a.v.s. i është përgjigjur: "Shkëlqimi i shpatave mbi kokën e tij ka qenë sprovë e mjaftueshme për të". (Transmeton An-Nasai)